



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep. DPK Dep. DPK Nr. i faq. 02 Broj stranica 02 Nr. pages 02	Nr. Prot. 03-02/3962/16 Br Prot. 03-02/3962/16 Prot No. 03-02/3962/16 Data 26.10.2016 Datum 26.10.2016 Date 26.10.2016	
PRISHTINE		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.10.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3383-16, për Zyrtarin e lartë z. Gëzim Kokollari-Këshilltar në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3383-16, për Zyrtarin e lartë, z. Gëzim Kokollari-Këshilltar në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Kokollari është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Kokollari është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/3894/16, DPK/Dpki-03-02/3895/16) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, z. Kokollari tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar në biznes privat, duke emëruar një person të besuar në te, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Shaip Havolli /